

Rrezikoheni për t'u infektuar:

Hepatiti A

- nga kontakti i ngushtë me persona të infektuar (p.sh. anëtarë të familjes ose partnerë erotikë të infektuar)
- nga mjedise të infektuar të përdorimit të përbashkët (p.sh WC-të)
- nga uji i infektuar, ushqime të freskëta që janë larë me ujë të infektuar ose ushqim i gatuar jo siç duhet, i përgatitur nga person i infektuar

Hepatiti B

- nga kontakti seksual me person të infektuar
- nga sende të infektuara me gjak (p.sh. shiringa, brisqe rroje, furça dhëmbësh, gjilpëra)
- nga kontakti me gjak personi të infektuar brënda në familje
- nga nëna e infektuar (foshnjat e porsalindura, gjatë lindjes)
- nga gjaku ose derivate gjaku të infektuar të depozituar para viti 1975 (tepër të rralla sot, për shkak të kontrollit sistematik te dhuruesit e gjakut)
- Nuk përhapet nga uji, ushqimi, enët e guzhinës, WC-të ose me kontaktet shoqërore (dhënie e dorës, përqafimi, puthja, kolla, tështitja)

Hepatiti C

- nga sende të infektuara me gjak (p.sh. shiringa, brisqe rroje, furça dhëmbësh, gjilpëra)
- nga gjaku ose derivate gjaku të infektuar të depozituar para viti 1992 (tepër të rralla sot, për shkak të kontrollit sistematik tek dhuruesit e gjakut)
- rrallë nga kontakti seksual me person të infektuar
- rrallë nga nëna e infektuar (foshnjat gjatë lindjes)
- Nuk përhapet nga uji, ushqimi, enët e guzhinës, WC-të ose nga kontaktet shoqërore (dhënie e dorës, përqafimi, puthja, kolla, tështitja)



Si të mbroheni?

Hepatiti A

- duke respektuar me rreptësi rregullat e higjenës personale (psh. larja e duarve mbas shkuarjes në WC dhe para gatimit engrënies)
- me vaksinim në raste të veçanta (psh. përpara çdo udhëtimi në shtete me përhapje të madhe të sëmundjes, osë të personave që vuajnë nga sëmundje kronike të heparit)

Hepatiti B

- duke përdorur prezervativ gjatë kontaktit seksual
- duke mos huazuar shiringa, gjilpëra, gëershërë, prerësa thonjsh, ose sende personale (p.sh. furça dhëmbësh, brisqe rroje)
- duke qënë i bindur se përdor sende të sterilizuara gjatë përpunimit të thonjve, punksionit, tatuazhit, shpimit në vende të ndryshme të trupit etj
- me vaksinim

Hepatiti C

- duke mos huazuar shiringa, gjilpëra, gëershërë, prerësa thonjsh, ose sende personale (p.sh. furça dhëmbësh, brisqe rroje)
- duke qënë i bindur se përdor sende të sterilizuara gjatë përpunimit të thonjve, punksionit, tatuazhit, shpimit në vende të ndryshme të trupit etj
- duke përdorur prezervativ gjatë kontaktit seksual, kur ke partnerë seksualë të përkohshëm ose të shumtë. Nuk rekomandohet përdorimi i domosdoshëm i prezervativit në çiftet monogamikë (p.sh. bashkëshortët)
- nuk ka vaksinë kundër hepatitit C



Mëso
se sa rrezikon, si të mbrohesh

zhdruk
dyshimet me një analizë të thjeshtë gjaku
tani menjëherë!

QENDRA E KONTROLLIT TË SËMUNDJEVE TË POSAÇME INFETKIVE
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE E SOLIDARITETIT SOCIAL
SEKSIONI I NDËRHYRJEVE NË KOMUNË - ZYRA E HEPATITEVE
Ruga «3 Septemvri» 54, 104 33 Athinë, Tel. 210 88 99 000, 210 88 99 237, 210 88 99 248, Fax 210 88 99 240

PROGRAMI
KOMBËTAR
I HEPATITIT
VIRAL



HEPATITI



në të gjitha moshat, në mqedise të ndryshme
në shumë aktivitete

NJË
PREZAKI
PADUKSHENIMI

PROGRAMI
KOMBËTAR
I HEPATITIT
VIRAL



Mëso
dhe Mbrohu